

Home > Aktualitet > Lëvizte me miliona, kokainë, e armë Glock, arrestohet në Tiranë Bledi Haka, i s...

AKTUALITET

Lëvizte me miliona, kokainë, e armë Glock, arrestohet në Tiranë Bledi Haka, i shpëtoi vdekjes 8 vite më parë (VD)

[Si u arrestua Bledi Haka në Tiranë](#)

Arrestohet te Liqeni Artificial Bledi Haka. 38-vjeçarit iu gjetën dhe sekuestruan para, një armë zjarri, kokainë, karta banke, celularë dhe celësa makine. 8 vite më parë, Haka shpëtoi nga një ngjarje e rëndë ku mbeti i plagosur pas një sherri me disa persona të tjerë.

Kokainë, glock dhe 20mln lekë, arrestohet 38-vjeçari te Liqeni, i gjenden thik...



17 Tetor, 2019 11:26

TIRANË– Bie në prangat e Policisë, 38 vjeçari Bledi Haka. I riu, u arrestua nga reparti “Shigjeta”, në zonën e Liqenit Artificial në Tiranë. Hakës, i janë sekuestruar edhe armë zjarri, fishekë, lëndë narkotike dhe karta banke. Siç shihet edhe në videon e publikuar nga vetë Policia e Shtetit, Haka është vënë në pranga teksa udhëtonte me një mjet tip “Benz”, me një vlerë të konsiderueshme.

Pas një kontrolli rutinor, Hakës iu gjetën disa doza kokaine, një armë e llojit Glock, 2 mln lekë të reja të ndara në prerje 50-she dhe karta banke. Gjithashtu iu sekuestruan edhe disa karta banke, çelësa automjesh dhe celularë.

Bledi Haka nuk është një person që përmendet për herë të parë në dosjet e Policisë së Shtetit. 38-vjeçari i ka shpëtuar vdekjes tetë vite më parë, teksa pas një sherri për motive banale, Bledi Haka mbeti i plagosur së bashku me tre shokët e tij, Shaqir Shtisi, Ervin Larku dhe Dritan Qello.

Katër të rintjë ishin të ulur bashkë në një lokal në Porcelan dhe më pas kanë pasur një debat me pronarin e lokalit shtetasin me initiale Sh Sh. 47 vjeç...

Pas sherrit, 47 vjeçari u ka treguar të afërmve të tij për konfliktin dhe në lokal ka mbërritur nipi i pronarit.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Me armë në dorë, Endrit Daci u fut në lokal dhe qëllloi me armë zjarri drejt katër të rinjve. Ata u plagosën dhe u dërguan në Spitalin Ushtarak dhe aty u kuruan. I lënduar lehtë ka mbetur edhe vetë pronari i lokalit.

Daci u akuzua fillimisht për vrasje të mbetur në tentativë dhe prokuroria kërkoi deklarinin fajtor të të dyshuarit dhe dënimin e tij me 23 vjet heqje lirie. Pas 11 muajve në gjykim, u rrëzuan të dyja kërkesat e Prokurorisë u ndryshua akuza.

I riu u gjykua për veprën penale “plagosja në kapërcim të kushteve të mbrojtjes së nevojshme” në dëm të shtetasve **Bledi Haka** dhe Dritan Qello dhe armëmbajtja pa leje dhe u dënua me 5 vite burg.

(f.m;f.g/dosja.al)

DR. LIGHT

ETIKETA: #arrestohet bledi haka #bledi haka

216

SHARES



Previous article

**Robert Goro: 30 vjet në tranzicion.
Përgjegjësinë më të madhe e kanë vetë
qytetarët**

Next article

**“Më kënaq”, pas “sherrit” nënë e bijë, Olti
Curri i tregon Ritës se Roza është shumë
mirë(Video)**

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*